

## **Pyetjet e shpeshta në lidhje me blerjen e Bankës NBG Albania nga ABI Bank**

Kemi kënaqësinë e vecantë t'ju njoftojmë për bashkimin e dy bankave ABI Bank dhe NBG Albania.

Nga data 3 Korrik 2018, Banka NBG Albania është blerë nga Banka Amerikane e Investimeve (ABI Bank). Ky transaksion u aprovua në 6 Qershor 2018 nga Banka e Shqipërisë. ABI është pjesë e grupit të mirënjohur amerikan NCH Capital ([www.nchcapital.com](http://www.nchcapital.com)) me qendër në New York. NCH Capital ka 3 miliardë dollarë asete në menaxhim dhe një eksperiencë 11 vjecare në Shqipëri.

ABI Bank është banka me rritjen më të lartë të aseteve dhe nivelin më të ulët të kredive të këqija në treg. Kapitali i saj është i fortë dhe mjaftueshmëria e kapitalit është ndër më të lartat në treg. Ky dinamizëm, i kombinuar me përvojën e NBG-së dhe shtrirjen e saj të gjerë në shumë qytete, mundesojnë një bashkim të suksesshëm.

Filozofia e ABI Bank dhe e NBG është të qenurit një bankë butik me shërbime dhe produkte të përshtatura për klientët. Kjo strategji nuk do të ndryshojë. Banka e bashkuar përtej shërbimit të personalizuar do të ofrojë dhe mundësitë e një banke më të madhe - më shumë degë, ATM dhe më shumë produkte.

E kuptojmë që mund të keni pyetje për të cilat po japim përgjigje si më poshtë. Jemi të hapur ndaj çdo pyetjeje tjetër që mund të keni. Qëllimi ynë është që ky transformim të ketë sa më pak paqartësi për ju.

### **1. Do të vazhdoj të përdor llogarinë time apo kartat e lidhura me to?**

Po, ju lutem vazhdoni normalisht të përdorni llogaritë dhe kartat egzistuese. Për çdo ndryshim të mundshëm në të ardhmen do të njoftoheni në kohë nga personeli i NBG/ABI.

### **2. Do të ndryshojë depozita ime? Po pagesat e kredisë do të vazhdojë ti kryejë si më parë?**

Çdo aktivitet i bankës do të vazhdojë normalisht si gjithmonë. Për çdo ndryshim të mundshëm në të ardhmen do të njoftoheni në kohë nga personeli i NBG/ABI.

### **3. Do të ndryshojë IBAN i llogarisë time?**

IBAN nuk do të ndryshojë. Për çdo ndryshim të mundshëm në të ardhmen do të njoftoheni në kohë nga personeli i NBG/ABI.

**4. Si do të veprojnë të dy bankat - do bashkohen apo do të operojnë vecmas?**

Të dy bankat për momentin do të operojnë si dy institucione financiare më vete – me logo të ndryshme. Pas bashkimit ligjor (bashkim me përthithje), i cili pritet të përfundojë në muajt në vazhdim do të jemi me logo të unifikuar – Banka Amerikane e Investimeve ose ABI Bank.

**5. A do të ndryshojnë produktet e Bankës?**

Mund të ketë ndryshime por gjithmonë do të jenë për të përmirësuar produktet aktuale të ofruara. Ju do të informoheni në kohë për çdo ndryshim. Një ndër përfitimet e mëdha të këtij bashkimi është mundësia për të përfituar më shumë produkte konkurruese si për individë apo biznese.

**6. Do të ketë mbyllje degësh?**

Nuk ka asnjë plan për mbyllje degësh apo ndryshim personeli të degëve.

Ju lutemi për çdo informacion të kontaktoni në adresat:

[info@abi.al](mailto:info@abi.al)

[info@nbgal.groupnbg.com](mailto:info@nbgal.groupnbg.com)